

# H Y L L I I D R I T Ë S

## E PËRKOHSHME KULTURALE - LETRARE

---

### **Editorial**

A po vdesin shqiptarët si komb? 3

### **Kasem Biçoku**

Kisha e shën Trinisë e formulës së pagëzimit 6

### **Aleksandër Mexi**

Aspekte të historisë së Ileshkvisë së Sapës dhe lista e ipeshkvijve 37

### **Bardhyl Demiraj**

Johannes Brunius Olchini (+1571) 49

### **Lucia Nadin - Mario Bonaldi**

Il presbitero albanese Girolamo Messio, la chiesa di San Sebastiano a Venezia, le pitture di Paolo Veronese 63

### **Italo Sarro**

Il martirio dei francescani Salvatore da Offida e Paolo da Mantova nel 1644 90

### **Bardhyl Demiraj**

<Pun t'nevoiscime me u dytun per me Scelbue Scpjrtin ...> 111  
– Romae 1828, 1776 apo 1773 (?)

### **Kurt Gostentschnigg**

Shkolla e parë shqipe në Kosovë dhe politika arsimore e Austro-Hungarisë ndaj territoreve shqiptare 119

### **Bahri Beci**

Probleme të metodës së studimit të dukurive dialektore të shqipes 129

<b>Pietro Di Marco</b> Un monastero nella storia culturale <i>arbëreshe</i>	<b>144</b>
<b>Injac Zamputti</b> Pozita shoqnore e grues malësore shqiptare sipas Kanunit	<b>166</b>
<b>Ervis Reçi</b> Mustafa Kruja në përpjekjet për krijimin dhe konsolidimin e shtetit shqiptar	<b>193</b>
<b>Arba Baxhaku</b> Rreth rindërtimit të Kishës së Shën Mërisë së Vaut të Dejës përmes një rrëfimi lundruës mbi Drin	<b>203</b>
<b>ARKIVI I HYLLIT</b>	
Letërkëmbim ndërmjet Luigj Gurakuqit dhe Sotir Gjikës (1919-1921)	<b>210</b>
<b>KRONIKË</b>	
Kuvendi albanologjik “Shqipëria në Arkivin e Propagandës Fide” në Vatikan (26-27 tetor 2015)	<b>249</b>
<b>NEKROLOGJI</b>	
Hans-Jürgen Sasse (1943-2015)	<b>254</b>
Aleksandër Stipçeviq (1930-2015)	<b>260</b>

**<Pun t' nevoiscime me u dytun per me Scelbue Scpjrtin ...>  
– Romae 1828, 1776 apo 1773 (?)**

“Errando discitur.”

Është fat i madh për shkencat e sotme filologjike dhe historiografinë shqiptare që dikush ka ngritur ndërkohë tëbanën e tij të dytë në ambientet e Arkivit Sekret e të Bibliotekës Apostolike të Vatikanit, në ato të Arkivit Historik të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s e gjetkë në Romë, pikërisht aty ku gjurmon, mbledh, kreh e sistematizon rregullisht atë material të bollshëm dokumentar mbi historinë dhe jetën sociale e kulturore (fetare) qoftë të diasporës historike shqiptare në Itali, ashtu edhe të trevave veriore në hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan në kapërcyell të Mesjetës (ballkanike), shi ku dhe kur rropateshin atëbotë për mbijetesë popullsia katolike shqiptare së bashku me klerin katolik. Ky dikush ka ngadhënjyer me kohë mirënjohje dhe është gjithherë i mirëseardhur ndër lexuesit e Hyllit tonë të Dritës, e kjo jo thjesht dhe vetëm falë studimeve të veta në varg mbi historinë e Kishës Katolike dhe gjendjen e popullsisë shqiptare të Veriut në kapërcyell të Mesjetës, por edhe si zbulues përmendoresh të vjetra shqipe në shek. XVIII, aq të dëshiruara dhe pak të kërkuara në historiografinë e kulturës së shkrimit shqip. Lejohem kështu qysh në hyrje të këtij shkrimi të thukët t'i drejtohem me përkushtim – pra në mënyrë krejt të zakonshme!!! – studiuesit arbëresh, duke dashur të vë në pah një tjetër veti të tij fatlume: bash angazhimin e tij social dhe intelektual me zgjatur dorën patëkeq e me ndarë fjalën e mendjen e tij në halle e derte që u shfaqen e u rëndojnë herë pas here e rast pas rasti kolegëve të llojit të vet, d.m.th. atyre studiuesve albanologë që e kanë bërë të udhës të punojnë kryesisht me fakte historike-kulturore të burimit të parë. Parë nga kjo perspektivë, ky shkrim nuk do të realizohej assesi si i tillë pa i paraprirë së pari konsultimit intensiv me kolegun dhe mikun tim Italo Sarro.

\* \* \*

Shkrimi ynë merr në analizë një rast aspak të rrallë në historinë e albanologjisë, shi kur përballemi me të ashtuquajturën ‘çoroditje’ të

diskursit shkencor-intelektual, sa i përket përcjelljes së të dhënave burimore të një materiali arkivor ose botimi që janë regjistruar në fakt qëmoti si të mirëqena në analet e kulturës së shkrimit shqip, por që kërkojnë dhe mëtojnë ende verifikimin e nevojshëm sidomos lidhur me vendin dhe kronologjinë e përftimit, përkatësisht me autorësinë e njërit apo tjetrit syresh<sup>1</sup>. Këmbëngulim fort në këtë detaj me karakter tashmë kryesisht njohës-enciklopedik, edhe pse për rastin konkret, për fat nuk janë përfshirë në këtë 'çoroditje' të gjitha rrethet intelektuale-shkencore të lexuesve sqimatarë në hapësirën kompakte shqipfolëse. E kjo për një arsye fare të thjeshtë, thuajse banale: e dhëna dokumentare bibliografike që kemi fokusuar në shkrimin tonë të radhës – siç pritej dikur dhe pritet edhe sot rëndom, kur bëjmë fjalë për traditën kulturore-shkrimore të Veriut!!! – nuk është rrokur e përfshirë as në ribotimin e fundit, por aspak fatlum të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar në plot tri vëllime (FESH, Tiranë 2008-2009).

Prashtu edhe objektin dhe qëllimin e këtij vëzhgimi shpejtua m'ia kumtojme lexuesit qysh në titull. Bëjmë fjalë pikërisht për një tekst shqip me shtampë të shtypshkronjës së Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s e që mban titullin <Pun t' nevoiscime me u dytun per me Scelbue Scpjrtin ...> (= /Pun t'nevojshime me u dītun per me shelbue shpirtin .../), botuar në Romë në shtypshkronjën e Propaganda Fide-s e që ndërkohë na rezulton me dy data botimi: 1828 dhe/ose 1776.

Sa i përket historikut të tekstit, vërejmë fillimisht se gjallesën e tij e kumton së pari sllavisti dhe ballkanologu i njohur Franz Miklosich dora vetë, i cili nuk mungon ta radhisë si të tillë, d.m.th. si material gjuhësor burimor në punimin e vet të parë shkencor mbi shqipen<sup>2</sup>: "1828 / Pun t' nevoiscem me u dytun per me scelbue spjrtin etc.", duke vendosur si vend dhe cak kohor botimi: "Romae 1828. Ex Typis S[acra] C[ongregatione] de propaganda fide. Dy fletë në [formatin] 8<sup>o</sup>". As më shumë e as më pak, por vetëm kaq. Sigurisht që falë këtij regjistrimi të bërë prej një studiuesi të mirënjohur për akribinë e vet shkencore, ky tekst vjen e citohet me pas – madje deri në ditët tona – si dëshmi gjuhësore burimor prej një numri të konsiderueshëm studiuesish dhe bibliografësh të shkencave albanologjike, edhe pse ndokush për hir të korrektesës shkencore nuk e fsheh dhe nuk ka përse ta fshehë pasigurinë që, pas gjithë gjasash, përpos Miklosich-it, askush pas tij nuk duhet të

<sup>1</sup> Khs. p.sh. Demiraj, Bardhyl: Mallkimet që lëshon ipeshkvi të Enjten e Madhe (1744 ?), në: „Hylli i Dritës” 3-4 [2014] 140-163. Për një rast të ngjashëm, siç është viti i zbulimit të „Mesharit” të Gjon Buzukut prej Imz. Gjon P. Nikollë Kazazit shih Demiraj, Bardhyl: Kur u zbulua “Meshari” i Buzukut, në: “Buzuku dhe shkrimet e hershme shqipe. Aktet e “Sesionit Shkencor Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë Shqiptare“. Tetovë 18, 19 dhe 20 mars 2005, Tetovë 2006, f. 145-156.

<sup>2</sup> Miklosich, Franz: “Albanische Forschungen”, bl. I, Wien 1870, f. 6.

ketë pasur kontakt e kaluar nëpër dyar këtë tekst shqip. Lejohem të citoj me këtë rast vetë konstatimin e filologut dhe bibliografit të njohur shqiptar Dhimitër Shuteriqi, i cili na kumton sa vijon:

“Nr. 274 (1828) / Pun t’ nevoisem me u ditun per me shembue shpjrtin etc. Romae 1828. Ex Typis C. de propaganda fide / Në 8°. Përshkruam s[i]p[as] Miklosich AF, I, 342.

Nuk dimë asgjë për këtë vepër, të ndonjë Anonimi nga Veriu i Shqipërisë, e cila njihet si libri i parë shqip i botuar prej Prop. Fides në shek. XIX, pas një heshtjeje prej 85 vjetësh që nga libri i Kazazit. Bibliografitë dhe autorët e ndryshëm që flasin për të, japin vetëm titullin, pa asnjë sqarim, duke u bazuar, si duket, të gjithë te Miklosichi. V. edhe:

Meyer EW, 521;

Manek-Pekmezi 21, japin gabim: *Prin t’nevojshem*;


Rrota, Hist e alfabetit 9-10” (Shuteriqi 1976 192)

Asgjëmangut këtë listë mund ta plotësojmë edhe me prurje të mëvonshme bibliografike albanologjike<sup>3</sup>, pa mëtuar aspak të kemi tash apo të kemi pasur dikur ndërmend me ndërmarrë një krehje ballore për gjithë atë material bibliografik që disponojmë. Synimi ynë rreh gjatë dhe ka të bëjë pikërisht me një kolizion të përfutur në fakt para do vitesh – por të sapovënëre prej nesh – me zbulimin dhe botimin e një përmendoreje të hershme të shkrimit shqip (“Hylli i Dritës” 4 [2008] 161vv.), për të cilën si zbuluesi ashtu edhe botuesi i saj i parë – Italo Sarro dhe Ardian Ndreca<sup>4</sup> – e fiksojnë në kohë në vitin 1776 e për rrjedhojë edhe dallojnë aty pendën e Imz. Gjergj Engjëll Radovanit [= it. *Giorgio Angeli Radovani*], ipeshkëv i atëhershëm i Dioqezës së Shkodrës, si autori që ka përpiluar e hedhur në letër të bardhë këtë tekst<sup>5</sup>, madje as nuk ngurroi ta përkthejë atë edhe në italisht me synimin dhe dëshirën e mirë që, pas marrjes së lejes së botimit prej instancave përkatëse, të mundësohej shumëfishimi në shtypshkronjën e Propaganda Fide-s, duke mundësuar kështu edhe shpërndarjen e tij ndër klerikët dhe besimtarët e thjeshtë në Dioqezën e Shkodrës.

3 Shih Hetzer, Armin: Geschichte des Buchhandels in Albanien. Prolegomena zu einer Literatursoziologie, Berlin 1981, f. 68, [me dyshim] 89.

4 Ndreca, Ardian: Nji tubëz lutjesh shqip e vitit 1776, në: “Hylli i Dritës” 4 [2008] 161vv.

5 APF SC Albania et Macedonia, bl. 13, fol. 1005v (= dsh. shqip), fol. 1006r-v – 1007r-v (= varianti i botuar), fol. 1008r (= dsh. italisht).



Faksimile 1: APF SC 13, fol. 1005r<sup>6</sup>

Tekstit në fjalë i përkushtoi vite më pas edhe shkruesi i këtyre radhëve një shkrim të vetin, duke e parë dhe trajtuar variantin në dorëshkrim (Var. A) krahas atij të botuar/redaktuar (Var. B) nga një tjetër perspektivë, përkatësisht si dëshmi qoftë të normës gjuhësore, sado rudimentare, të gegnishtes letrare të kohës (= Var. B), ashtu edhe të të ashtuquajturit “substandard” i shkrimit të lirë e të papërkorë gegnisht (= Var. A), i cili ndikohej atëbotë drejtpërsëdrejti prej ligjërimit të thjeshtë në qytetin e Shkodrës.<sup>7</sup> Tash vërejmë rastësisht që titulli i këtij teksti, i fiksuar nga Italo Sarro dhe Ardian Ndreca për vitin 1776 e me autor Imz. Gjergj Engjëll Radovanin përkon kryekëput me titullin e tekstit shqip, të regjistruar për herë të parë prej Miklosich-it, por që është datuar prej tij në vitin 1828.

Lutjes sime për një riverifikim të mundshëm të datimit të këtij dokumenti në analet e Arkivit Historik të Propagandës, nuk i mungoi – ashtu siç edhe pritej!!! – reagimi i menjëhershëm pozitiv i Italo Sarros, si vijon:

“[...] sono stato ieri in archivio. Le preghiere sono quelle pubblicate su H[ylli i] D[ritës], 4/2008 A[rchivio] P[ropaganda] F[ide], Fondo Albania, vol. 13, c. 1005r-1008r. Sono le ultime pagine del librone: la prima pagina è 1005 (Albania), segue 1005v che inizia con Pun [= dsh. shqip – Var. A], poi 1006r-1007v a stampa [= teksti i botuar – Var. B]

<sup>6</sup> APF SC Albania et Macedonia, bl. 13, fol. 1005r: “Atti | Di Adorazione, e Ringraziamento, | Di Fede, Speranza, Carità e Contrizione in Albanese, tradotti ad verbum in Italiano, accioche, se | saran approvati, si degnino fare molte stampe p[er] uso di questa | Diocesi di Scutari.”

<sup>7</sup> Demiraj, Bardhyl: Norma gjuhësore dhe substandardi në një tekst shqip të shek. XVIII në arealin kulturor të Veriut, HD 1 [2011] 79-96.

e infine pagina 1008r [= dsh. italisht – Var. C: përkthimi] che inizia con Atti Necessari. Manca la data, ma il documento precedente riporta quella del 18 maggio 1776. Il testo è stato scritto personalmente dal vescovo Giorgio Angeli Radovani. La scrittura è uguale a precedenti lettere contenute nel fondo. D'altra parte Il vescovo stesso nella c. 963r del 30 agosto 1675 per giustificare il ritardo con cui invia una relazione scrive così: "hò dovuto da per me solo tutta comporla, e poi ricopiarla con molto mio stento per non avere chi in ciò mi possa aiutare". Se hai bisogno di altro fammelo sapere. [...]" (mail më 12.07.2015)

Siç shihet e rezulton edhe nga ky pasazh, verifikimi i materialit dokumentar në shqyrtim prej zbuluesit të tekstit, që konsiston si në hetimin e mjedisit arkivor që ofron sistematizimi dhe vendndodhja e tij në vëllimin përkatës, ashtu edhe, madje sidomos, në përqasjen e llojit të shkrimit në tekstin shqip dhe italisht në dorëshkrim me atë të letërkëmbimit të Imz. Gjergj Radovanit në po atë vëllim, e bëjnë tashmë sa tumirës aq edhe bindës përfundimin e sjellë shtatë vite më parë prej Italo Sarros dhe Ardian Ndrecës [2008 161vv.], sa i përket autorësisë, e për rrjedhojë edhe fiksimit të një kronologjie të paktën relative në përfitim, përkatësisht botimin e tekstit. Me siguri mund të deduktojmë gjithashtu, se ka qenë pikërisht mungesa e datimit qoftë e varianteve në dorëshkrim, ashtu edhe ajo e variantit të botuar, shkak kryesor i asaj 'lajthitjeje'<sup>8</sup> të përftuar në listën bibliografike të dokumentacionit shqip që regjistroi i pari sllavisti dhe ballkanologu i njohur Franc Miklosich dhe që e hasim si të tillë deri në ditët tona.

Por a kemi të bëjmë vërtet me një hartim ose/edhe botim të tekstit shqip pikërisht në vitin 1776? Kjo pyetje rezulton tashmë për Italo Sarron si e ezauruar: mjafton të mbajmë këtu parasysh vendndodhjen e materialit dokumentar në vëllimin në fjalë menjëherë pas dokumentit të parafundit, i cili, sipas tij, datohet më 18 maj 1776. Gjithsesi, ndryshe nga konstatimi mbi autorësinë e tekstit, përkatësisht deduktimi i saj, falë përqasjes së llojeve të shkrimit në gjithë atë vëllim, këtë vëzhgim të dytë shkruesi i këtyre radhëve e përcolli fillimisht me një farë dyshimi të vagët, meqë materiali në fjalë, edhe pse i padatur: a) përmbyllte një vëllim të konsiderueshëm me plot 1008 folje, e për më tepër b) ngërthente si i tillë korrespondencën e klerit vendor me Kongregacionin e Shenjtë të Propaganda Fide-s, e zhvilluar kjo gjatë viteve 1771-1775.<sup>9</sup>

Këtë dyshim tonin e përforcoi edhe më shumë verifikimi i materialit

<sup>8</sup> Sipas Sarro-s në mesazhin e cituar: "... se è uguale è chiaro che il testo del 1828 è una copia di quello del 1776."

<sup>9</sup> ASPF SC Albania et Macedonia, vol. 13 (1771-1775)


arkivor po prej nesh gjatë qëndrimit të fundit në Arkivin Historik të Propagandës (28-30 tetor 2015), kur vumë re në të një parregullsi shtesë lidhur me datimin e mirëfilltë të letrës që i paraprin këtij materiali. Kjo letër rezultoi të jetë shkruar e firmosur bash më datë 26 dhjetor 1775 në Pëdhanë prej Padre Giuseppe da Carife, atëbotë prefekt i Provincës Françeskane të Maqedonisë,<sup>10</sup> andaj edhe radhitja e saj në fund të atij vëllimi rezultoi tashmë të jetë e patëmetë. Si e tillë ajo duhet të ketë trokitur në dyert e Kongregacionit së Shenjtë të Propaganda Fide-s, qoftë edhe formalisht, një vit më vonë, pra në vitin 2016, duke u arkivuar më pas si e tillë edhe prej sekretarit të këtij institucioni me shënimin përkatës: <Macedonia | Il P. Giuseppe da Carife si lagna de' uecchi Missionarij , e chiede i nuoui. | Li 18 Maggio 1776"

Sqarimi i kronologjisë së letrës prijëse, përkatësisht rrethana që autori dhe përmbajtja e saj s'kanë të bëjnë aspak me materialin gjuhësor në shqyrtim, vë tash jo thjesht e vetëm në pikëpyetje, por përjashton bindshëm vitin 1776 si vit të hartimit, përkatësisht të botimit të tekstit tonë shqip. Të vetmen alternativë zgjidhëse ndaj kësaj çështjeje të rihapur do ta mundësonte në këtë rast hetimi assesi i lehtë i të paktën gjithë vëllimit në fjalë me jo më pak se 1008 folje (= 2016 faqe) në dorëshkrim. Dhe shkruesi i këtyre radhëve i përjetoj ato çaste sa të lodhshme aq edhe të këndshme, duke i kaluar të gjitha dorëshkrimet nëpër duar. E për fatin e tij fatlum arriti të kërkojë, të lexojë e së fundi të zbulojë një vend ashtu të fshehur mes faqesh e rreshtash, bash në një letër-përgjigje të shkruar e firmosur prej Imz. Radovanit në Rrjoll, më dt. 24 korrik 1773:

---

<sup>10</sup> Khs. ASPF SC Albania et Macedonia, vol. 13 (1771-1775) fol. 2005v: <Pedana li 26 Xb.<sup>e</sup> 1775 / Umilis:<sup>mo</sup> Obligati:<sup>mo</sup> e Divotis:<sup>mo</sup> Seruo / Padre Giuseppe da Carife Pref.<sup>o</sup> A: di Macedonia>.





Faksimile 2: Pjesë nga letra e Imz. Gjergj Radovanit dërguar Propagandës: ASPF SC Albania et Macedonia 13 (1771-1775), fol 399.<sup>11</sup>

Në këtë pasazh të letrës së Imz. Gjergj Radovanit, bash në paragrafin e tretë të saj, mësojmë se:

„E treta [letër juaja – B.D.] ishte e dt. 22 maj [1773 – B.D.], në të cilën vërej fatmirësisht jo vetëm të jetë miratuar botimi në shqip i akteve të virtyteve hyjnore, por madje të më dërgohet mua një numër i konsiderueshëm ekzemplarësh. Për gjithë

<sup>11</sup> Riprodhimi diplomatik: “[D]’un tempo stesso ricevo tre venerabile lett<sup>e</sup> dell’ Em.ze V.re. La prima dei 13. Febro<sup>o</sup> in cui rilevo che si sono compiaccute di rimettere la parte Orientale di Cuculi sotto Barbulusci giusta il pristino decreto dei 13 Gennaio 1768 con il qual provvedimento si sono contestate quelle povere anime. Sebbene p[er] altro ancora non hò publicato tal ordine, si perche hò dovuto di ciò dar avviso a Mons<sup>re</sup> d’ Alessio acciò si regolasse; e si ancora perche essendoci li 30 scorso Maggio uniti con il prelodato Mons<sup>re</sup> e coll’ Arcivesc:º d’ Antivari ch’ è provisto p[er] ora alle spirituali indigenze dei Cuculani lasciandoli sotto la cura di Barbulusci pro interim, e di nuovo esponendo le loro istanze a Cot<sup>a</sup> S. Cong<sup>re</sup>, le quali a quest’ ora saranno pervenute. Se poi faran ricorsi, quanto prima dovrò publicarlo.

La seconda fù dei 20 Marzo, in cui contr’ ogni merito si sono legnate l’ Em.ze V.re assegnare trenta scudi per fabbricar una cella in Trumsci Inferiore, ed altre tanti p[er] una simile in Laggiacondi.

La terza era dei 22 Maggio, in cui rilevo non solo d’aver benignamente accondisceso a far stampare in Albanese gli atti delle virtù Teologali, ma eziandio di spedirmene un buon numero di esemplari. Di tutti questi favori infinite grazie rendo alla singolar bontà dell’ Em.ze V.re. [...]” (ASPF SC Albania et Macedonia, vol. 13, fol. 399r.)

këtë dashmirësi i jam shumë mirënjohës shpirtmadhësisë së veçantë të Eminencave Tuaja.”

Në këtë paragraf shpresojmë tash të kemi të fiksuar përfundimisht edhe datën 22 maj 1773 si cak kohor *post quem non* të hartimit të materialit në dorëshkrim prej Imz. Gjergj Radovanit, sikurse më pas edhe të botimit të tij në Romë në shtypshkronjën e Propaganda Fide-s.

\* \* \*

Duke mbyllur edhe këtë çështje të fundit lidhur me historinë e tekstit në shqyrtim, mund të shtojmë së fundi, se vetëm falë bashkëpunimit kolegjial me studiuesin e apasionuar arbëresh Italo Sarron, i cili po i zbardh faqen shkencës së sotme historiografike shqiptare, mundëm të plotësojmë edhe atë qëllim që i vumë vetes në këtë studim modest, pasi mënjanoam bindshëm edhe një kolizion çoroditës kronologjik në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip. Vëmë kështu njëherësh theksin mbi nevojën e gjithëhershme për plotësimin e analeve të historisë së mendimit albanologjik: së pari, me të dhëna sa më të sakta të karakterit filologjik e bibliografik për atë trashëgimi që disponojmë; e së dyti, me shkallën e njohjes që përshkon kulturën e shkrimit shqip sidomos në fazat e para të dokumentimit të saj.

### **Abstract**

The paper analyses an early text in Albanian by the then Archbishop of Shkodra Msgr Gjergj Radovani, and possibly written before May 1773, when it was imprinted in the typography of Propaganda Fide. It is rather common with early texts in Albanian to discuss about the accuracy of bibliographic data recorded by previous researchers. These records need further analysis, especially as regards their dating and additional data about the preparation work prior to their edition. Such was the case of this early text *unearthed* by Italo Sarro when studying documents in the Archives of Propaganda Fide.